



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1039/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1039/2023 të datës 28.07.2023 të ankuesi _____, me adresë _____, rruga _____, pa numër në Graçanicë, kundër Vendimit me Nr. Prot: 584-2 të datës 16.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1039/2023 e datës 28.07.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II.Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Prot: 584-2 i datës 16.06.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më datë 27.02.2023 ka shpallur konkursin sipas kodit SP-NJP-02 për pozitën Zyrtar për Prokurim, i cili më datë 15.03.2023 është vazhduar edhe për shtatë (7) për shkak të mos arritjes të numrit të balancuar të kandidatëve sipas përfaqësimit etnik. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në fazat e

procedurës (listën e ngushtë, testin me shkrim dhe intervistën me gojë). Pas përfundimit të këtyre fazave të procedurës në bazë të raportit të vlerësimit të përzgjedhjes së kandidatëve rezultoi që ankuesi nga numri i përgjithshëm i pikëve ka marr gjithsej 99 pikë, që janë të pamjaftueshme për të qenë kandidat fitues, si rrjedhojë ankuesi më datë 24.04.2023 nga burimet njerëzore përmes emailit është njoftuar për anulimin e konkursit.

Ankuesi kundër njoftimit të datës 24.04.2023 të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më datë 22.05.2022 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot: 584 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës më datë 16.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. prot: 584-2 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke e vërtetuar njoftimin e datës 24.04.2023.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. Prot: 584-2 të datës 16.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të cilin në bazë të librit të dorëzimit e ka pranuar më datë 07.07.2023, më datë 28.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5438/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 03.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 11.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:Ankesën e datës 28.07.2023 me numër protokoli 5438/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 08.05.2023 nga ankuesi për V.D lidhur me kërkesën për qasje ne dokumente zyrtare; Emailin e datës 08.05.2023 nga burimeve njerëzore për ankuesin; Njoftimin për anulimin e konkursit nga burimeve njerëzore për ankuesin përmes emailit të datës 24.04.2023; Emailin e datës 05.05.2023 nga ankuesi për burimet njerëzore; Ftesë për intervistë e datës 07.04.2023 për ankuesin nga burimet njerëzore; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim e vitit 2020; Certifikatën Themelore Profesionale për Prokurim me Nr. 179; Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim 2014-2016; Certifikatën Themelore Profesionale të prokurimit 2011-2013; Certifikatën e profesionalizimit në prokurim 2010, 2009, 2008; Certifikatën e profesionalizimit në prokurim me Nr. 111/07; Certifikatën e profesionalizimit në prokurim 2005; Certifikatën e datës 27.12.2006; Certifikatën me Nr. 013/22 e datës 26.02.2022; Certifikatë Kontabilitet dhjetor 2008; Vendimin me Nr. Prot: 584-2 të datës 16.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Ankesën me Nr. Port: 584 e datës 22.05.2023 të ankuesit; Letër motivuese e ankuesit; Formularin për punësim të ankuesit i datës 13.03.2023; Dokument identifikimi i ankuesit; CV-në e ankuesit; Diplomën me Nr. 2252; Certifikatë trajnime e datës 27.11.2004; Certifikatë trajnimi prej 15-18.02.2013; Certifikatë për periudhën 29.09-02.10.2011; Certifikatë trajnimi për datën 22-25.03.2012; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 09.02.2023;

Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 01.11.2022; Vërtetimin e datës 24.08.2022; Akt Emërimit e datës 05.12.2014, 07.10.2011; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.06.2011; Referencë Ref.nr.463 e datës 15.02.2011; Referencë Nr. 7163 e datës 23.02.2006; Vërtetimin lidhur me përvojën e punës e datës 19.08.2015; Vërtetimin e marrëdhënies së punës i datës 19.08.2015; Letër referimi e datës 12.12.2003; Letër Rekomandimi I datës 15.06.2002; Konkursin për pozitën Zyrtar për Prokurim I datës 27.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 11.08.2023; Njoftimin për zgjatjen e konkursit i datës 15.03.2023; Vendimin për emërimin e Komisionit Përzgjedhës i datës 21.03.2023; Regjistrin e kandidatëve aplikues; Listën e vlerësimeve të aplikacioneve e datës 22.03.2023; Kërkesën për punësim të ankuesit e datë 13.03.2023 me dokumentacionet tjera; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë I datës 23.03.2023; Formularin për renditjen e kandidatëve për testin me shkrim; Ftesë për pjesëmarrje në testin me shkrim e datës 28.03.2023 nga burimet njerëzore për ankuesin; Lista e rezultateve të testit me shkrim e datës 06.04.2023; Testin me shkrim të ankuesit; Lista e kandidatëve të cilët do të nënshtrohen intervistës me gojë e datës 14.04.2023; Raporti I vlerësimi të përzgjedhjes së kandidatët për pozitën Zyrtar për Prokurim; Njoftimin e datës 24.04.2023 për anulimin e konkursi të dërguar për ankuesin përmes emailit; Vendimin e datës 23.05.2023; Dëshmi nga libri i dorëzimi i datës 07.07.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, konstatoi se janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë konkretisht Vendimi me Nr. Prot: 584-2 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është nxjerr më datë 16.06.2023, ndërsa pala ankuese të njëjtin sipas librit të dorëzimit e ka pranuar më datë 07.07.2023, mbi këtë bazë ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Prot: 584-2 të datës 16.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pretendon se ky vendim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuere të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; gjatë procedurës ka pasur shkelje të nenit 1 dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Komisioni Përzgjedhës është emëruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi; Vlerësimi i testit me shkrim dhe intervistës me gojë është bërë në mënyrë të kundërligjshme; Me rastin e anulimit të konkursit nuk është dhënë udhëzimi juridik mbi mjetin juridike për ankesë; Kështu që kemi pasur shkelje të parimeve të meritës dhe shkelje procedurale e materiale në këtë procedurë.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se në këtë procedurë janë shkelur dispozitat e nenit 1 dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se

Gjykata Kushtetues e Republikës së Kosovës në Aktgjykimin për rastin Nr. KO 203/19 të datës 09.07.2020, ka theksuar që Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet për nëpunësit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sepse cenohet pavarësia e një institucioni të pavarur kushtetues, më konkretisht, konkretisht sipas nenit 208 të këtij aktgjykimi përcaktohet se: *“Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese, të përcaktuara me Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, Gjykata iu referohet Institucioneve të Pavarura shprehimisht të renditura në Kapitullin XII [Institucionet e Pavarura], konkretisht në nenet 132- 135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit], 136-138 [Auditori i 51 Përgjithshëm i Kosovës], 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave], si dhe përkitazi me Gjykatën siç është përcaktuar në Kapitullin VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës. Në këtë aspekt, Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre. Rregullimet të cilat krijojnë “ndërhyrje” të drejtpërdrejta në pavarësinë funksionale dhe organizative të tyre janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parimet e vlerat e proklamuara aty”, ndërsa sipas pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi është vendosur se: “TE KONSTATOJE që Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet ne raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetute”, rrjedhimisht dispozitat e Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për nëpunësit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar, ndërsa dispozitat ligjore të parashikuara për shërbyesit civil zbatohen për nëpunësit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës deri në atë masë sa ato dispozitat të mos kenë ndikim në pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese.*

Lidhur me pretendimin ankimore të ankuesit se ka pasur shkelje të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sa i përket edhe vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se konkursi sipas kodit SP-NJP-02 për pozitën “Zyrtar për Prokurim” të shpallur më datë 27.02.2023 nga Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është shpallur në pajtim me dispozitat e nenit 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Komisioni Përzgjedhës për këtë procedurë është themeluar në pajtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje i cili sipas kompetencave të tij të përcaktuar me paragrafin 6 të këtij neni, ndërsa edhe procedurat tjera si përgatitja e listës së ngushtë, procedura e testit me shkrim dhe me gojë janë bërë në përputhje me dispozitat e neneve nga 20 deri 31 të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Nisur nga procedura e vlerësimit të testit me shkrim, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesit nga numri i përgjithshëm i pikëve të testit me shkrim është vlerësuar me gjithsej 80 pikë nga 100 të mundshme dhe mbi këtë bazë ka kaluar pragun për t'iu nënshtruar fazës së intervistës me gojë i cili nga Komisioni Përzgjedhës në intervistë me gojë është vlerësuar me gjithsej 19 pikë, ndërsa nga vlerësimi i tërësishëm i pikëve të testit me shkrim dhe me gojë ankuesi ka grumbulluar gjithsej 99 pikë e që në kuptim të dispozitave të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kanë qenë të pamjaftueshme për të qenë ankuesi si kandidat i suksesshëm, ngase nuk ka marr numrin e pikëve prej 100 të tilla, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, vlerëson se në procedurë të rekrutimit nuk ka ndonjë mekanizëm i cili do të mund të kontrollonte vlerësimin e përgjigjeve në intervistë me gojë për shkak që vlerësimi i intervistës me gojë është në kompetencë dhe diskrecion të plotë të Komisionit Përzgjedhës, andaj nisur nga gjendja faktike dhe juridike, Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i testit me shkrim dhe intervistës me gojë është bërë në pajtim me nenin 29 dhe nenin 31 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, ndërsa procedura është anuluar për shkak që asnjë nga kandidatët nuk ka arritur numrin e pikëve të kërkuara për emërim.

Lidhur me komunikimin e rezultateve të testit me shkrim dhe me gojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se referuar dispozitave të nenit 33 të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, konstaton se njoftimi për anulimin e konkursit i është dërguar ankuesit përmes emailit në pajtim me këtë nen, ndërsa lidhur me pretendimin se njoftimi për anulimin e konkursit nuk përmban udhëzim juridik, Kolegji i Këshillit, në vështrim të dispozitave ligjore të aplikueshme konkretisht me nenin 49 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuese të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"1. Kur një nëpunës administrativ, ose kur një kandidat, në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një personi tjetër në atë pozitë nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasoje e parregullsive në zbatimin e rregullave dhe të procedurave, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Gjykatës Kushtetuese, i cili e shqyrton ankesë dhe vendos për atë"*, si rezultat i kësaj ankuesit nuk i është mohuar asnjë e drejtë në lidhje me kundërshtimin e njoftimit për anulimin e konkursit, si rrjedhojë njoftimi për anulimin e konkursit i datës 24.04.2023, nuk konsiderohet akt administrativ por i njëjti është akt real i përcaktuar me nenin 69 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe mbi këtë bazë nuk mund të aplikohen dispozitat e elementeve të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të këtij ligji, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar në këtë kuptim.

Sa i përket vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr. Prot: 584-2 të datës 16.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me rastin e vendimmarrjes në këtë procedurë administrative, ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, duke shqyrtuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike dhe është vendosur në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative dhe Rregullore Nr. 04/2015 për Procedurat e Rekrutimit, të Emërimit dhe të Punës Provuere të Stafit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë të pabazuara.

Nisur nga konstatimet si më sipër, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"*, në shqyrtim të tërësishëm të procedurës së rekrutimit për pozitën *"Zyrtar për Prokurim"*, konstaton se në këtë procedurë nuk janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1039/2023, datë 08/09/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.